



Prishtinë, 24 mars 2010  
Kodi i ZRRE-së: V\_227\_2010

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Nenin 15.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë të amendamentuar me Ligjin Nr.03/L-080;
- Rregullin për Licencimin e aktiviteteve të Energjisë Elektrike;
- Dispozitat e Nenit 20 par. 2 të Licencës për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes KEK SH.A.; dhe
- Kërkesën me shkrim të Korporatës Energjetike të Kosovës KEK SH.A. të dërguar në ZRRE me datë 02.02.2009,

**Në mbledhjen e mbajtur me 24 mars 2010 nxori këtë:**

### VENDIM

**APROVOHET** kërkesa e KEK SH.A-së për emërimin e Z. Ramadan Dibrani, si ekspert të pavarur, i cili do të bëjë kontrollin teknik dhe të sigurisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

### Arsyetim

1. KEK SH.A. sipas Nenit 20 par.2 (Shëndeti dhe Siguria) të Licencës për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes të energjisë elektrike, ka për obligim të propozojë një ekspert të pavarur, emërimin e të cilit do ta aprovojë ZRRE-ja.
2. KEK SH.A. ka dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE), me datë 02 shkurt 2009 kërkesën për miratimin e **Z. Ramadan Dibrani, inxhinier. i diplomuar. i elektroteknikës.**, si ekspert i pavarur.
3. ZRRE ka shqyrtuar kërkesën e KEK SH.A. dhe pas vlerësimit të biografisë së kandidatit ka aprovuar kërkesën që **Z. Ramadan Dibrani, inxhinier i diplomuar. i elektroteknikës**, të jetë ekspert i pavarur i cili, në bazë vjetore, do të kryejë kontrollin (auditimin) teknik dhe të sigurisë së njësisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes

Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të përkthimeve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

Vendimi hyn në fuqi datën e miratimit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërmëdhjetë (14) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar